Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 01/506
Datë: 05.08.2022

Në mbështetje të neneve 6 dhe 16 të Ligjit Nr.03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare, si dhe Udhëzimit Administrativ të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) për Kriteret dhe procedurat për akreditimin e institucioneve që zbatojnë njohjen e mësimit paraprak në Kosovë nr. 09/2019, Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), në mbledhjen e mbajtur me datë 05.08.2022 nxjerrë këtë:

VENDIM

1. **Riakreditohet** institucioni QPAP "OXFORD STUDIO", me adresë: Prishtinë me 4 qendra, Prizren me 2 qendra, Gjilan me 2 qendra, Klinë me një qendër, Gurakoc me një qendër dhe Istog me një qendër, Republika e Kosovë, për periudhën tre (3) vjeçare, përkatësisht nga data 31.01.2022 deri 30.01.2025, për të ofruar, vlerësuar dhe certifikuar këtë kualifikim:

1.1 Kurse të Gjuhës Angleze, niveli A1 deri në C2, institucioni mund të realizojë procesin e aftësimit e aftësimit sipas të dhënave të mëposhtme:

Prishtinë qendra Nr. 1, Rr. Kodra e Diellit, Rruga 3, Obj3, Ll4, Prishtinë: Institucioni mund të realizoj procesin e aftësimit deri me gjashtëmbëdhjetë (16) kandidat në një grup dhe gjatë një viti mund të ketë deri në 108 grupe.
Prishtinë qendra Nr. 2, Rr.Lagja Ramiz Sadiku, Prishtinë: Institucioni mund të realizoj procesin e aftësimit deri me gjashtëmbëdhjetë (16) kandidat në një grup dhe gjatë një viti mund të ketë deri në 76 grupe.
Prishtinë qendra Nr. 3, Rr. Dardania. Lidhja e Pejës, Bl9/a, Prishtinë: Institucioni mund të realizoj procesin e aftësimit deri me gjashtëmbëdhjetë (16) kandidat në një grup dhe gjatë një viti mund të ketë deri në 80 grupe.
Prishtinë qendra Nr. 4, Rr. Bregu i Diellit, Mat 1, Lagjja Dafina, Objekti 1, Hyrja 2, Nr.6, Prishtinë: Institucioni mund të realizoj procesin e aftësimit deri me gjashtëmbëdhjetë (16) kandidat në një grup dhe gjatë një viti mund të ketë deri në 76 grupe.
Prizren qendra Nr. 1, Rr. Rruga e Seraqëve, nr.26, Prizren: Institucioni mund të realizoj procesin e aftësimit deri me gjashtëmbëdhjetë (16) kandidat në një grup dhe gjatë një viti mund të ketë deri në 36 grupe.

Prizren qendra Nr. 2, Rr. Zahir Pajaziti, lok nr.18/II, Prizren: Institucioni mund të realizoj procesin e aftësimit deri me gjashtëmbëdhjetë (16) kandidat në një grup dhe gjatë një viti mund të ketë deri në 32 grupe.
Gjilan qendra Nr. 1, Rr. Abdullah Tahiri, Gjilan: Institucioni mund të realizoj procesin e aftësimit deri me gjashtëmbëdhjetë (16) kandidat në një grup dhe gjatë një viti mund të ketë deri në 24 grupe.
Gjilan qendra Nr. 2, Rr. Muharrem Ibrahimi, Gavran, Dardania, nr.1, kati 2, Gjilan: Institucioni mund të realizoj procesin e aftësimit deri me gjashtëmbëdhjetë (16) kandidat në një grup dhe gjatë një viti mund të ketë deri në 16 grupe.
Klinë, Rr. Muhamet Haxhaj Nr.13, Klinë: Institucioni mund të realizoj procesin e aftësimit deri me gjashtëmbëdhjetë (16) kandidat në një grup dhe gjatë një viti mund të ketë deri në 20 grupe.
Gurakoc, Rr. Lagjeja e Kabashve, p.n. Gurrakoc: Institucioni mund të realizoj procesin e aftësimit deri me gjashtëmbëdhjetë (16) kandidat në një grup dhe gjatë një viti mund të ketë deri në 4 grupe.
Istog, Rr. UÇK, Nr.100, Istog: Institucioni mund të realizoj procesin e aftësimit deri me gjashtëmbëdhjetë (16) kandidat në një grup dhe gjatë një viti mund të ketë deri në 8 grupe.

2. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m

Në bazë të kërkesës së "QPAP "OXFORD STUDIO", për akreditim dhe rekomandimeve të dala nga Raporti i ekipit të ekspertëve mbi akreditimin e institucionit, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Rekomandimet përfundimtare të ekipit të ekspertëve janë të mbështetura në dëshmi dhe dokumente të ofruara nga institucioni në fazën e aplikimit: Aplikacionin për akreditim si institucion ofrues dhe/ose vlerësues dhe lëshues të kualifikimit; Raportin e Vetëvlerësimit; Vizitën në institucionin/ofruesin aplikues, si dhe dokumente tjera shtesë.

Pas trajtimit në detaje nga ekipi i ekspertëve të dokumentacionit të sipërpërmendur dhe të gjeturave nga vizita, ekipi i ekspertëve në raportin e hartuar dha vlerësim pozitiv, dhe të njëjtin ia rekomandoi Këshillit Drejtues për vendimmarrje. Mbi këtë bazë, Këshilli Drejtues, bazuar në kompetencat e tij, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 20, pikat 1, 2, 3 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ të MASHT për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë me Nr. 35/2014. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet KD të AKK, në afat prej 15 ditësh pas lëshimit të vendimit.

Vendimi u dërgohet:

1. Institucionit, QPAP "OXFORD STUDIO", dhe
2. Arkivit të AKK-së.

Prof. Dr. Agron BAJRAKTARI

Kryetar KD-së AKK